



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 67/5 prot.

Tiranë, më 01.10.2020

VENDIM
Nr.104, datë 01.10.2020

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 209, DATË 27.12.2019

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 209, datë 27.12.2019, të Komisionerit, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”*,

KONSTATOVA SE:

Me vendimin nr. 33, datë 19.04.2019, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave”*, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin Paralajmërues nr. 209, datë 27.12.2019, të Komisionerit, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”*.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet

administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues dhe në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes.

Duke analizuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, arrij në përfundimin se, nga ana e institucionit të mbikëqyrur, Drejtoria e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, janë zbatuar plotësisht detyrat e lëna në vendim. Konkretisht:

1. Departamenti i Administratës Publike, me mbështetjen e grupit të ekspertëve të projektit të financuar nga fondet IPA 2014, *“Zbatimi i Reformës së Shërbimit Civil në Administratën Publike”*, ka filluar punën në drejtim të klasifikimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil dhe më gjerë.
2. Sipas akteve të administruara në dosjen e verifikimit, rezulton se, institucioni i mbikëqyrur ka miratuar rregulloren e brendshme, duke mbajtur parasysh rekomandimet e lëna në vendimin paralajmërues të Komisionerit.
3. Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrur ka vendosur përfundimin e marrëdhënies së punësimit për punonjës të ***** , për shkak të mospërmbushjes së kriterit të posaçëm të pozicionit të punës *“Specialist”*, në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit.
4. Institucioni i mbikëqyrur ka dërguar pranë Departamentit të Administratës Publike përshkrimet e punës për çdo pozicion të shërbimit civil, me qëllim marrjen e konfirmimit zyrtar nëse ato janë të hartuara në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar.
5. Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ka plotësuar dosjen e personelit të çdo nëpunësi civil, duke përfshirë në të, të gjitha dokumentet e evidentuara në mungesë në aneksin nr. 2 (*pjesë e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes*).

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 209, datë 27.12.2019, të Komisionerit, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr. 209, datë 27.12.2019.

3. Për këtë vendim të njoftohet Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, si dhe Departamenti i Administratës Publike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha